



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTAKT NORMATIV

Nr. _____, datë _____

PËR

**DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.137/2020, “PËR BUXHETIN
E VITIT 2021”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në ligjin nr.137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Nenet 1, 2, 3 dhe 4, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“Neni 1

Buxheti për vitin 2021 është:

Të ardhurat	507 727	milionë lekë;
Shpenzimet	628 269	milionë lekë;
Deficiti	120 542	milionë lekë.

Ai përbëhet nga buxheti i shtetit, buxheti vendor dhe fondet speciale, sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe kompensimi i ish-pronarëve.

Neni 2

Buxheti i shtetit për vitin 2021 është:

Të ardhurat	373 746	milionë lekë;
Shpenzimet	494 288	milionë lekë;
Deficiti	120 542	milionë lekë.

Neni 3

Buxheti vendor për vitin 2021 është:

Të ardhurat 57 940 milionë lekë,

nga të cilat:

- transferta e pakushtëzuar e përgjithshme	18 480	milionë lekë;
- transferta e pakushtëzuar sektoriale	8 206	milionë lekë;
- transferta specifike për shlyerje detyrimesh	500	milionë lekë
- transferta specifike për menaxhimin e mbejeteve urbane	39	milionë lekë
- transferta specifike për emergjencat civile	564	milionë lekë
- të ardhura të tjera	30 151	milionë lekë;
Shpenzimet	57 940	milionë lekë.

Neni 4

Buxheti i sigurimeve shoqërore për vitin 2021 është:

1. Sigurimi i detyrueshëm, programet kompensuese dhe trajtimet e veçanta:

Të ardhurat, gjithsej 141 633 milionë lekë,

nga të cilat:

- kontributet	89 340	milionë
lekë;		
- transferimet nga buxheti i shtetit	46 573	milionë
lekë;		
- transferta për indeksimin e pensioneve	2 220	milionë
lekë;		
- bonusi i pensionistit	3 500	milionë lekë
Shpenzimet	141 633	milionë lekë.

Paga minimale, për efekt të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, është e barabartë me pagën minimale në shkallë vendi dhe ndryshon sa herë që ndryshon kjo pagë. Këshilli i Ministrave përcakton masën e kontributit për personat e vetëpunësuar në bujqësi, si dhe të

kategorive të veçanta të personave të vetëpunësuar. Për vitin 2021, teprica ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas degëve dhe programeve të sigurimit shoqëror të detyrueshëm e suplementar, përdoret për mbulimin e deficitit të degës së pensioneve.

2. Sigurimi suplementar

Të ardhurat, gjithsej	7 532	milionë lekë,
nga të cilat:		
- kontributet	1 931	milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	5 421	milionë lekë;
- Transferta për indeksimin e pensioneve	180	milionë lekë;
Shpenzimet	7 532	milionë lekë.

Fondi për indeksimin e pensioneve është parashikuar 2 400 milionë lekë. Përdorimi i këtij fondi bëhet sipas përcaktimeve në nenin 61, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Shpenzimet administrative, si pjesë e shpenzimeve totale për skemën e sigurimeve shoqërore, janë jo më shumë se 2 500 milionë lekë dhe ndahen sipas skemave në proporcion me shpenzimet e drejtpërdrejta.

Nga teprica e të ardhurave dhe fondi rezervë i sigurimeve shoqërore përdoren 4 000 milionë lekë për financimin e shpenzimeve si më sipër.”.

Neni 2

Paragrafi i parë, i nenit 5, ndryshohet, si më poshtë vijon;

“Buxheti i sigurimeve shëndetësore për vitin 2021 është:

Të ardhurat, gjithsej,	46 136	milionë lekë,
nga të cilat:		
- kontributet dhe të tjera	15 084	milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	31 052	milionë lekë;
Shpenzimet	46 136	milionë lekë.”.

Neni 3

Neni 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 6

Buxheti i fondit për kompensimin në vlerë të pronarëve për vitin 2021 është:

Të ardhurat, gjithsej,	2 700	milione lekë,
nga të cilat:		
- të ardhura të tjera	1 700	milione lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	1 000	milione lekë;
shpenzimet	2 700	milione lekë.”.

Neni 4

Në nenin 7, shifra e fondit të rindërtimit ndryshohet dhe bëhet “... 35 000 milionë lekë ...”.

Neni 5

Nenet 9 dhe 11, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“Neni 9

Të ardhurat e buxhetit të shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

grantet	19 353	milione lekë;
të ardhurat tatimore	332 793	milione lekë;
të ardhurat jotatimore	21 600	milione lekë.

...

Neni 11

Shpenzimet e buxhetit të shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

- shpenzime të buxhetit qendror	480 788	milione lekë;
- fondi rezervë i buxhetit	9 000	milione lekë;
- kontingjencë për risqet e borxhit	4 500	milione lekë.

Kufiri i shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion, në nivel programi, për

shpenzime korrente dhe kapitale, është sipas tabelës 1, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Në tabelat 1/1 dhe 1/2 janë kufijtë e shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion, në nivel programi, për shpenzime korrente dhe kapitale, përkatësisht për vitet 2022 dhe 2023. Transferta e pakushtëzuar për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore miratohet vetëm për vitin 2021.

Të ardhurat e shpenzimet e buxhetit, sipas zërave kryesorë, për dy vitet e mëparshme fiskale dhe tri vitet e ardhshme janë sipas tabelës 4.

Njësitë e qeverisjes së përgjithshme mund të fillojnë procedurën e prokurimit që në muajin nëntor të vitit korrent, nëse fondet janë akorduar/regjistruar në sistemin e thesarit për dy vitet pasardhëse, me kushtin që lidhja e kontratës të bëhet efektive vetëm pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Kriteret bazë, masa e përfitimit, mënyra e përdorimit të fondit prej 740 milionë lekësh, të përcaktuar në shpenzimet korrente të programit buxhetor 04250 “Zhvillimi rural duke mbështetur prodhimin bujqësor, blegtoral, agroindustrial dhe marketingun” në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimin Rural, për skemën e mbështetjes së naftës për bujqësinë, si dhe financimi i ngritjes së sistemit të shpërndarjes dhe monitorimit, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Gjendja e mjeteve monetare, që do të rezultojë në fund të vitit buxhetor 2021 në llogarinë unike të thesarit, si rezultat i mosrealizimit të shpenzimeve ose tejkalimit të të ardhurave, transferohet në llogarinë e shpronësimeve në Bankën e Shqipërisë në masën jo më shumë se 3 miliardë lekë dhe përdoret me vendime të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 6

Tabelat 1 dhe 4, që përmenden në nenin 11, zëvendësohen me tabelat 1 dhe 4, që i bashkëlidhen këtij akti normativ.

Neni 7

Në nenin 15 bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i fundit ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Shuma 500 milionë lekë si transfertë specifike shpërndahet sipas bashkive, duke marrë si kriter peshën e detyrimeve të secilës bashki ndaj totalit të

detyrimeve të prapambetura të muajit shtator 2021. Ky fond përdoret për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, duke nisur nga detyrimi më i vjetër i papaguar.”.

2. Tabela nr.3, që përmendet në këtë nen, zëvendësohet me tabelën me të njëjtin numër që i bashkëlidhet këtij akti normativ.

Neni 8

Në nenin 20, paragrafi i fundit ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Qeveria mund të akumulojë dhe mund të mbajë në llogarinë unike të Këshillit të Ministrave në Bankën e Shqipërisë çdo gjendje shtesë të likuiditetit që mund të krijohet e mbartet për të financuar buxhetet e viteve fiskale pasardhëse, por, në mbyllje të vitit buxhetor, gjendja e akumuluar nuk duhet të kalojë vlerën mesatare prej dy muajsh kumulativë të shpenzimeve buxhetore të planifikuara për atë vit buxhetor.”.

Neni 9

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

Lindita NIKOLLA